



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-04

**Prokurori kundër Pjetër Shalës**

**Vendosi:** Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 9 shtator 2022

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Ndryshimin e Afatit**

---

**Prokurorit të Specializuar**

Xhek Smith

**Mbrojtjes së të akuzuarit**

Zhan-Lui Zhilisen

**Mbrojtësit të viktimave**

Sajmon Loz

**GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE**,<sup>1</sup> në bazë të nenit 39(13) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullave 9(5)(a), 9(6) dhe 76 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), nxjerr këtë vendim.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 21 korrik 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) që, deri më 2 shtator 2022, të dorëzonte parashtrime dhe sqarime shtesë në lidhje me masat mbrojtëse për dëshmitarët e kësaj çështjeje gjyqësore dhe Mbrojtjen që, deri më 9 shtator 2022, të dorëzonte përgjigjen e saj.<sup>2</sup>
2. Më 2 shtator 2022, ZPS-ja dorëzoi parashtrimet e saj (“Parashtrimet e ZPS-së”).<sup>3</sup> Versioni i redaktuar konfidencial i tyre u dorëzua vetëm më 5 shtator 2022.
3. Më 8 shtator 2022, për shkak të afateve që binin ndesh me njëri-tjetrin, Mbrojtja kërkoi zgjatjen me dhjetë ditë të afatit për t’iu përgjigjur parashtrimeve të ZPS-së duke filluar nga dita e njoftimit të parashtrimeve konfidenciale të ZPS-së, d.m.th. deri më 15 shtator 2022 (“Kërkesa”)<sup>4</sup>. Mbrojtja parashtron se ZPS-ja i dorëzoi Parashtrimet e saj më 5 shtator 2022, duke shkurtuar kështu kohën e Mbrojtjes për dhënien e përgjigjes.<sup>5</sup> Mbrojtja gjithashtu parashtron se ekzistojnë arsye të vlefshme, pasi

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-04, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 14 shkurt 2020, publik.

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-04, F00235, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Tretë të Prokurorit të Specializuar për Masa Mbrojtëse për Materiale të Rregullës 102(3) të Kërkuara nga Mbrojtja*, 21 korrik 2022, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 55(c). Versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua po të njëjtën ditë.

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-04, F00261, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë për Materiale që janë Objekt i Masave Mbrojtëse sipas Rregullës 81(1)(a)*, 2 shtator 2022, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-3, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua më 5 shtator 2022.

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-04, F00268, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Mbrojtjes për Ndryshimin e Afatit të Përgjigjes ndaj F00162*, 8 shtator 2022, publike.

<sup>5</sup> Kërkesa, para. 3-4.

ndryshimi i afatit do t'i mundësonte të kryente detyrat e saj, pa vonuar në mënyrë të panevojshme procesin.<sup>6</sup>

## II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

4. Sipas nenit 39(13) të Ligjit, kur është e nevojshme, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund të nxjerrë çfarëdo urdhri që gjykohet i nevojshëm për përgatitjen e një gjykimi të drejtë dhe të shpejtë.

5. Sipas rregullës 9(5)(a) të Rregullores, nëse i tregohen arsye të vlefshme, ose *proprio motu*, paneli mund të zgjasë ose shkurtojë afatet e përcaktuara prej kësaj Rregulloreje apo prej panelit.

6. Sipas rregullës 9(6) të Rregullores, kur nuk i shkaktohet padrejtësi palës kundërshtuese, lejohet që vendimi në lidhje me një mocion për ndryshimin e afateve të merret duke mos i dhënë palës kundërshtuese mundësinë e shprehjes së mendimit.

7. Sipas rregullës 76 të Rregullores, përgjigja ndaj një mocioni dorëzohet brenda dhjetë (10) ditësh prej dorëzimit të mocionit, kurse kundërpërgjigja ndaj përgjigjes dorëzohet brenda pesë (5) ditësh prej dorëzimit të përgjigjes. Kërkesat për zgjatje të afatit paraqiten në kohë, për t'i lënë panelit kohë të mjaftueshme për marrjen e vendimit në lidhje me kërkesën para përfundimit të afatit përkatës.

## III. DISKUTIM

8. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se Kërkesa është paraqitur në kohë, siç përcaktohet në fjalinë e tretë të rregullës 76 të Rregullores.

9. Për sa i përket paraqitjes së arsyeve të vlefshme, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se vonesa në dorëzimin e versionit të redaktuar konfidencial të parashtrimeve të ZPS-së shkurtoi faktikisht kohën e Mbrojtjes për dhënien e përgjigjes nga shtatë ditë

---

<sup>6</sup> Kërkesa, para. 4.

në katër ditë dhe se Mbrojtja po përballet me një numër afatesh që bien ndesh me njëri-tjetrin.

10. Sa i përket ndryshimit të kërkuar të afatit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se kalimi i dosjes së çështjes gjyqësore Trupit Gjykues aktualisht është caktuar të bëhet të mërkurën, më 21 shtator 2022.<sup>7</sup> Afatet fillestare për dorëzimin e parashtrimeve të ZPS-së dhe përgjigjes së Mbrojtjes u caktuan me qëllimin për të rritur efikasitetin e çështjes gjyqësore dhe respektuar këtë afat. Duke pasur parasysh kalimin së shpejti të dosjes së çështjes gjyqësore për gjykim dhe duke qenë se parashtrimet e ZPS-së dhe përgjigja e Mbrojtjes do të duhet të përfshihen në Dokumentin Dorëzues për Trupin Gjykues përkatës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se ndryshimi i kërkuar i afatit është shumë i madh. Në vend të këtij afati të kërkuar, ai konstaton se Mbrojtja duhet të dorëzojë përgjigjen jo më vonë se të martën, 13 shtator 2022.

11. Bazuar në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se Mbrojtja ka paraqitur arsye të vlefshme për Kërkesën dhe zgjat afatin për dorëzimin e përgjigjes së Mbrojtjes deri të martën, **13 shtator 2022**. ZPS-ja, nëse dëshiron, mund të dorëzojë kundërpërgjigjen jo më vonë se të premten, **16 shtator 2022**.

12. Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se me marrjen e vendimit për Kërkesën pa marrjen e përgjigjes së ZPS-së, nuk shkaktohet ndonjë padrejtësi.

#### IV. VENDIM

13. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- (a) **MIRATON** pjesërisht Kërkesën dhe **ZGJAT** deri të martën, **13 shtator 2022**, afatin e dorëzimit të përgjigjes së Mbrojtjes ndaj Parashtrimeve të ZPS-së; dhe

---

<sup>7</sup> KSC-BC-2020-04, F00234, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar sipas Rregullës 102(2) dhe Kërkesat në lidhje me Të*, 20 korrik 2022, konfidencial, para. 46(f). Versioni i redaktuar publik u dorëzua po të njëjtën ditë.

(b) **URDHËRON** ZPS-në të dorëzojë kundërpërgjigjen, nëse do të ketë një të tillë,  
deri të **premtën, 16 shtator 2022.**

/nënshkrimi/

**Gjykatës Nikola Giju**

**Gjykatës i Procedurës Paraprake**

E premtë, 9 shtator 2022

Në Hagë, Holandë.